



# Njoftime mbi kthimin/ riatdhesimin vullnetar

ALBANISCH

## Çfarë ndodh nëse kërkesa juaj për azil refuzohet?




Së bashku me **refuzimin e kërkesës së azilit**, ju do të informoheni rreth një afati deri në të cilin, ju duhet të largoheni nga shteti. Kjo periudhë është zakonisht nga **një javë deri në 30 ditë**. Nëse ju nuk largoheni brenda këtij afati vullnetarisht nga shteti, atëherë ju mund të ktheheni/riatdhesoheni me forcë në vendin tuaj të origjinës (riatdhesimi). Ju atëherë do duhej t'i paguani vetë shpenzimet për riatdhesimin tuaj dhe për shumë vite nuk do të mund të hyni më ligjërisht në Gjermani ose edhe në një vend tjetër të BE-së (ndalimi i hyrjes). Ju nuk mund të qëndroni në Gjermani pa një leje të vlefshme të qëndrimit: Ju në çdo kohë duhet të llogarisni me arrestim nga policia dhe riatdhesimin në vendin tuaj të origjinës. Shfrytëzoni opsionin e kthimit/riatdhesimit vullnetar përpara se të fillojnë masat për përfundimin e qëndrimit tuaj.

## Kthimi/riatdhesimi vullnetar në vendin tuaj të origjinës mbështetet nga shteti gjerman

Programet e kthimit/riatdhesimit dhe riintegritimit ofrojnë ndihma të shumta - për shembull, nëse nuk keni para për të paguar vetë për udhëtimin tuaj largues. Për ata që kthehen vullnetarisht në vende të caktuara të origjinës, ofrohet mbështetje e mëtejshme për ta bërë më të lehtë fillimin nga e para në vendin e tyre të origjinës. Financimi ju mundëson të largoheni nga vendi në mënyrë të pavarur dhe të përgatitni me kujdes largimin tuaj.

## Çfarë mbështetje mund të përfitoni?

**Programi i kthimit/riatdhesimit** ju ofron përkrahje organizative dhe financiare kur largoheni vullnetarisht nga vendi.

- Mbartja e shpenzimeve të udhëtimit 
- Pagesa e një shume ndihme të konsiderueshme financiare 
- Marrja përsipër e shpenzimeve mjekësore 

**Programe të ndryshme riintegritimi** mund t'ju ndihmojnë për një fillim të ri në vendin e origjinës.

- Masat profesionale të kualifikimit 
- Ndihmë për gjetjen e një vendi pune 
- Ndihmesë për themelimin e një biznesi të vogël 
- Mbështetje në fushën e strehimit/banimit 
- Këshillim dhe mbështetje në fushën sociale dhe mjekësore 

## Ku mund të merrni informacione të mëtejme?

Në portalin e informacionit mbi kthimin/riatdhesimin vullnetar [www.ReturningfromGermany.de](http://www.ReturningfromGermany.de) ju mund të merrni informacione për vendet e origjinës, si dhe për programet e kthimit dhe riintegritimit si dhe të përdorni funksionin qendror të kërkimit në ueb, për të gjetur qendrën më të afërt të këshillimit për kthimin/riatdhesim. Ju gjithashtu mund të kontaktoni linjën telefonike të kthimit të BAMF: **+49 911 943 - 0**



## Këshillimi për kthimin/riatdhesimin do t'ju ndihmojë më tej

Nëse keni interesim për kthimin/riatdhesimin vullnetar në vendin tuaj të origjinës, ju mund t'i drejtoheni për të gjitha pyetjet Shërbimit për këshillimin e kthim/rikthimit.

- ➔ Këshillimi për kthimin është falas, i besueshëm (konfidencial) dhe individual.
- ➔ Ai ju mbështet gjatë organizimit dhe përgatitjes së largimit tuaj, rreth paraqitjes së aplikacioneve për mbështetje dhe, nëse është e nevojshme, me aplikimin ndihma të mëtejshme.
- ➔ Ju gjithashtu do të mbështeteni për sigurimin e dokumentacionit zëvendësues të pasaportës nëse nuk keni një dokument të vlefshëm udhëtimi.
- ➔ Një përkthyes/përkthyes do të angazhohet në mënyrë që të kuptoni gjithçka gjatë konsultimit. Megjithatë, mund të sillni edhe dikë me vete në qendrën e këshillimit të kthimit, i cili përkthen për ju.



## A është i mundur një kthim vullnetar në çdo kohë?

Kthimi vullnetar hap gjithashtu mundësi dhe perspektiva të reja në vendin e origjinës për azilkërkuesit, procedura të cilëve nuk ka përfunduar akoma dhe, për njerëzit që tashmë iu është miratuar qëndrimi.

**Ju mund të shkoni në shërbimin e këshillimit për kthimin edhe gjatë ecures së procedurës së azilit. Kjo nuk ka asnjë ndikim në rezultatin final të procedurës.**



**Të interesuar për një kthim vullnetar? Lini një takim me shërbimin më të afërt të këshillimit për kthimin:**